REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 143/17
Datë/Datum. 31.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherit të Prokurimit: **"Komuna Mamushe".**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Qazim Hoxha – Ekspert teknik – profesional Visar BIBAJ - Ekspert shqyrtues		
Lënda:	Raporti lidhur me Ankesen nr. **143/17**, parashtruar nga OE , **„Rosa Security"shpk, - Prizren .**		
Datë:	**31.05.2017.**		

Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me aktivitetin e prokurimit:**"Sigurimi fizik i objekteve të komunës së Mamushës"**, me nr. të Prokurimit: **626/17/001/236,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **"Komuna Mamushe"**, me përgjigjejet ndaj ankesës së operatorit ekonomik: **„Rosa Security"shpk, - Prizren,** me nr. **143/17,** të datës **15.05.2017.**

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues – teknik, lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.
Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - **"Komuna Mamushë".**
- Panelit Shqyrtues - **"OSHP".**
- OE - ankues - **„Rosa Security"shpk, - Prizren,**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES - TEKNIK

		24.05.2017		**26.05.2017**		**31.05.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën **15.05.2017**, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **143/17,** e parashtruar nga OE **„Rosa Security"shpk, - Prizren**, kundër AK / Komuna Mamushe, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Sigurimi fizik i objekteve të komunës së Mamushës"**, me nr. të Prokurimit: **626/17/001/236**.

Konform nenit 113.1, te LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komuna Mamushë.**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues , „Rosa Security"shpk, - Prizren.

Pikat e Ankesës nga OE **„Rosa Security"shpk, - Prizren**, *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 6, 7, 28, 51, 52, 56, 59, 60 dhe 72, të LPP-së

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Neni 6 ekonomiciteti dhe efikasiteti. AK – KK Mamushe ka bere shkelje te ketij neni, gjegjesisht pikes 1, ku ky nenn e obligon Ak qe fondet publike dhe burimet publike te perdoren ne menyre ekonomike ndersa nje gje e tille nuk ka ndodhur nga Ak sepse nuk ka shpall fitues neve si biznes edhe pse kemi qene me cmim me te ulet duke iplotesuar edhe kerkesat e tenderit.

Neni 7, Barazia ne trajtim jo diskriminim, AK – KK mamushe ka bere shkelje sepse gjate vleresimit te procedures tenderuese nuk na shpall fitues neve si OE konkurues pasi qe kemi qene OE qe i plotesojme kushtet me cmimin me te lire sipas kriterit te FDT-se, dhe sipas specifikimmit teknik duke bere pa barazi dhe trajtim jo te barabarte ndaj neve si Oe konkurues.

Neni 28 Specifikacionet teknike,

Neni 51, Njoftimi i kritereve te perzgjedhjes

Ne si Oe i kemi plotesuar te gjitha kriteret e dosjese se tendertit FDT, ndersa jemi eleminuar pasi qe ne d eklaraten tone nuk ceket rroga e punetoreve ne shumen prej 250 Euro.

Ndersa ne d eklaraten tone te dates 18.04.2017, te kerkuar nga AK konform kerkeses se

FDT-se ne deklarojme se "Rosa Security" shpk, nga Prizreni d eklaron per KK mAmushe se i permush te gjitha kriteret e dhena nga AK, si dhe eshte ne pajtueshmeri me te gjitha kushtet dhe specifikimet ne DT, te shpakllur nga Ak Mamushe me nr prok 626 17 001 236 .

Prandaj nda deklarataty shofim se biznesi im pajtohet me te gjitha kushtet dhe specifikat e kerkuara ne DT nga AK. Gjithashtu AK, ka vepru ne kundershtim me nenin 72, duke mos kerkuar sqarime dhe informacione shtese edhe pse qdo gje ka qe ne e kjart ne deklaraten tone. Gjithashtu nje dokument tjeter qe ne jemi eleminuar si te pa pergjegjeshem ka qene certefikata e cila sipas Ak, nuk ka qene e noterizuar edhe pse zyrtari i prokurimit deklaron se kjo nuk eshte deshmi qe mund te eleminoj, gjithashtu AK ka vepruar ne kundershtim me nenin 72, duke mos kerkuar sqarim dhe info shtese.

Prandaj AK mamushe ka bere shkelje te ketij neni duke na eleminuar pa bazu dhe pa argument ligjore. Gjithashtu kemi ofruar cmimin sipas kerkeses IV. II Kriteret e dhenjes (tenderi i pergjegjeshem cmimi me i ulet) se kerkuar ne paramase dhe parallogari nga Ak Komuna Mamushe pasi qe ne kerkese paramase eshte kerkuar cmimi me i ulet , ne si OE konkurues kemi plotesuar paramasesn sipas specifikimit teknik te percaktuar nga AK, te cilin jeni te obliguar ne pajtim me LPP neni 56, neni 60 ndersa komisioni ne vleresim ka bere vleresim te procedures tenderuese ne kundershtim me specifikimet teknike – Paramases dhe njoftimin e kritereve te perzgjedhjes te cilet kritere jane percaktuar ne DT.

Neni 52 Njoftimi i kritereve per dhenie te kontrates

AK KK-Mamushe, lidhur me kete procedure te prokurimit nuk ka bere vleresimin sipas kritereve te kerkuar ne dosjen e tenderit (FTD), pasi qe AK ka vleresuar OE "COMMANDO" SH.P.K., konkurues te pergjegjshem te cilet nuk i kan plotesuar kriteret e kerkuar ne dosje te tenderit e cila sipas LPP-se neni 52.3 eshte i obliguar te vlersoj me kriteret e percatkura ne FDT dhe me specifikimet teknike ne paramas dhe ne parallogari. OE i pripozurar per kontrat eshte themeluar ne maj te 2016, nuk ka aktivitet 3 vjeqar dhe te gjitha referencat jane jo ligjore dhe ne kundershtim me kerkesat e FDT prandaj ky OE nuk i ploteson kerkesat e FDT-se eshte i papergjegjshem.

Ndersa AK-se neve si OE konkurrues na shpalle te pa pergjegjshem me kritere dhe specifikime teknike – paramase dhe parallogari dhe kerkesat e FDT, qe jem me qmim me te ulet edhe pse ne jem te pergjegjshem dhe i plotesojm kerkesat e FDT.

Neni 56- dispozitat e pergjegjshme mbi perzgjedhjen e pjesmarreseve per dhenie kontrates

Ak-se KK- Mamushe nuk ka bere vlersimin e tenderit sipas dispozitave te pergjithshme sipas kerkesave te specifikuara ne njoftim e dhenjes se kontrates dhe dosjes se tenderit pasiqe OE fitues "Commando" shpk jane te papergjegjshem dhe nuk jane ne pajtim me LPP neni 52,56, neni 60 dhe neni 69 ndersa nuk na shpalle neve fitues pasiqe jemi OE te pergjegjshem dhe me qmim me te lire.

Neni 59 – ekzaminimi, vlersimi dhe krahasimi i tendereve

Ak-se KK-Mamushe ne procedur tenderimi, sipas raportit te vlersimit, nuk ka bere ekzaminim, vleresim dhe krahasimin e tendereve, ku ne si OE jemi te pergjegjshem me qmim me te lire spese i plotesojme te gjitha kriteret e kerkuara ne dosjen e tenderit.

Neni 60 – Kriteret per dhenie te kontrates

Ak-se nuk e ka respektu LPP sepse ka shpallur fitues OE qe nuk eshgte i pergjegjshem dhe

ka vere ne lajthitje AK-se, duke sjellur referenca jo-ligjore per punet te cilat jane ne proces te cilat ende nuk kane perfunduar dhe nuk dihet epilogu i vlersimit pozitiv apo negativ pa perfunduar, prandaj eshte veprim jo-ligjor, te pranohet diqka qe ende nuk dihet epilogu perfundimtar.

Neni 72- dokumentacioni dhe informacioni shtese

Ak-se nuk e ka respektuar LPP, gjegjesisht nenin 72, ku per "paqartesite e vet" konform ketij neni, ka mundur te kerkoj sqarime dhe informacione shtese edhe pse Deklerata e Biznesit eshgte shume e qarte dhe konform kerkeses se dosjes se tenderit.

Prandaj propozojme Ak-se, gjate procedures se Ri-shqyrtimit, te anuloje vendimin e komisionit mbi propozimin e dhenjes se kontrates biznesit "Commando" shpk, sepse ky vendim eshte i jashte ligjshem dhe ne kundeshtim me kerkesat e FDT-se.

Demet material:

Demet pos atyre morale jame i demtuar edhe ne aspektin financiar
Sigurimi i tenderit
Ankeseat
Dokumentet per pergaditjen e tenderit per konkurim
Demit ekonomik dhe financiar i fitimit te planifikuar shumes se projektit 10%.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	14.04.2017
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	shërbim/vlerë e vogël
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	20.04.2017
Data e hapjes së ofertave	20.04.2017
Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së :	28.04.2017

Kriteret për vlerësim

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

a. Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2.

b. Deklarata e nënshkruar nga Administrata Tatimore në vendin e themelimit të operatorit ekonomik se operatori ekonomik nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve, së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit për Kontratë ose para datës së dorëzimit të ftesës për Kuotimin e Çmimit.

c. Vërtetimi i lëshuar nga Themelore, Departamenti për çështje Ekonomike ose autoriteti kompetent ne vendin e themelimit të Operatorit ekonomik.

DËSHMIA E KËRKUAR DOKUMENTARE:

1. ***Një deklaratë me shkrim nën betim e plotësuar e nënshkruar, dhe e vulosur nga tenderuesi duke përdorur formularin në Aneksin 2.***

2. *Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit. (Kusht për nënshkrim të kontratës)*

3. *Vërtetimin nga Gjykata ekonomike - Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë"- të jetë i lëshuar se paku deri në gjashtë mujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit. Origjinali ose Kopje e vërtetuar (Kusht për nënshkrim të kontratës)*

Vërejtje: Dokumentet në pikën 2. dhe 3. më lartë janë të obliguara vetëm për O.E të rekomanduar nga komisioni për dhënien e tenderit, i cili duhet ti paraqesë këto dokumente para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të paraqitjes së dokumenteve të lartcekura, O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do ti refuzohet dhe do të vazhdohet me O.E. të dytë e kështu me radhë.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

a. Në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik është i përshtatshëm, duhet t'i dorëzojë Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik.

b. Operatori ekonomik duhet të ketë regjistruar numrin fiskal në ATK

c. Duhet të jetë deklarues i TVSH-së

d. Licenca për sigurimin fizik të objekteve

DËSHMIA E KËRKUAR DOKUMENTARE:

1. *Certifikata e regjistrimit të biznesit së bashku me pjesët e informatave të biznesit.*
2. *Certifikata e regjistrimit të numrit fiskal (nëse nuk është e përfshirë në certifikatën e regjistrimit të biznesit)*
3. *Certifikata e TVSH-së*

Kopja e noterizuar e licencës e lëshuar nga Institucioni Përkatës

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

N/A

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

N/A

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

1. *Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses minimum 3 kontrata për shërbime të ngjashme gjatë tri viteve të fundit (2014, 2015, 2016)*
2. *Operatori Ekonomik duhet të deklarohet se do ti punësoj dy punëtor nga qendra regjionale për punësim dhe do tua paguaj pagën minimale bruto 250.00 €*
3. *Operatori Ekonomik duhet të deklarohen se do ti sigurojnë licencat për 12 punëtor të angazhuar (PER FITUESIN E TENDERIT)*

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. *Lista e projekteve të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit e cila duhet të përmbajë shërbimet e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin, e dëshmuar me "Referencë" ose raport për realizimin me sukses të Kontratës.*
2. *Deklarata e nënshkruar dhe e vulosur nga OE pjesëmarrës.*

Deklarata e nënshkruar dhe e vulosur nga OE pjesëmarrës (FITUESI I TENDERIT DUHET TE SJELL KOPJET E LICENCAVE)

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"SFK"shpk	Prizren	7 132 80 €	JO
2.	"Rosa Security"shpk	Prizren	7 080 00 €	JO
3.	"Comando"shpk	Prizren	7 115 64 €	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 20.04.2017, *konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë tri 3) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.*

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Usejn Bilibani
- - Anëtar i komisionit - Besire Dulaku
- - Anëtar i komisionit –Hasim Morina

Data e mbarimit të vlerësimit: 26.04.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....27.04.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni vleresues pas ekzaminimit, vleresimit dhe krahasimit te secilit tender veq e veq konstatoi se OE me nr rendor 1 dhe 2, nuk kan ofruar tender te pergjegjeshem me pershtatje me kerkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate ndersa OE. Me nr rendor 3 , ka ofruar tender te pergjegjeshem ne perputhje me kerkesat e dosjes s e tenderit dhe njoftimit per kontrat. Andaj duke u bazuar ne kriterin per dhanje te kontrates, "Tenderi i pergjegjeshem me cmim me te ulet", komisioni unanimisht rekomandon qe OE, "Comando" te shperblehet me kontrat per arsye se ka ofruar tenderin e pergjegjeshem me cmimin me t e ulet ne mesin e tendereve pjesmarres.

Analiza dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues - teknik (N. 113, 114)

Ekspertët e OSHP-së, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqarojnë me sa vijon:

<u>Sqarim hyrës</u>

Autoriteti Kontraktues - Komuna Mamushë, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të kuotimit të çmimit, lloji i kontratës është shërbim, kontratë publike me vlerë të ulët. Ndaj kësaj procedure, operatori ekonomik ankues *"Rosa Security" shpk*, Prizren, ka parashtruar ankesë kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Kundër të njëjtit njoftim, i njëjti OE me datën 03.05.2017, përmes shkresës elektronike - e-mailit,

paraqet Kërkesë për Rishqyrtim tek AK, me pretendimet ankimore se komisioni i vlerësimit e ka kualifikuar si të përgjegjshme ofertën e operatorit ekonomik i cili ka ofertuar në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Kundrejt të njëjtës kërkesë AK – Komuna Mamushë, me daten 08.05.2017, nxjerr vendim për refuzimin e kërkesën si të pa bazuar, <u>përkatësisht e hedh poshtë si të paplotë.</u>

<u>Konstatimi 1</u> Fillimisht po sqarojmë se arsyetimi i mospranimit të Kërkesës për Shqyrtim si të pa plotë, vlerësojmë se është i gabuar.

Arsyetimi i AK se kjo kërkesë nuk është nënshkruar nga personi i autorizuar i operatorit ekonomik, është i pa bazë dhe krejtësisht i pa vend, sepse autorizimet e nënshkrimit brenda një subjekti ekonomik, nuk mund t'i dijë e as t'i përcaktojë AK. Kjo është çështje e brendshme e atij subjekti, i cili si ta sheh më të përshtatshme i cakton dhe i delegon autorizimet dhe kompetencat e përfaqësimit, llogaridhënies etj, konform rregulloreve brenda organizatës së vet. Për më tepër, kjo çështje nuk trajtohet në veçanti në legjislacionin e prokurimit.

Poashtu, kërkesa për plotësimin e informacionit drejtuar OE " Rosa Security", e dërguar pas orarit administrativ (*ora 16: 50, provë: e-maili, pjesë e shkresave të lëndës*) me shtrirje në dy ditë tjera të vikendit, objektivisht ka filluar të rrjedhë nga data 08.05.2017, kur në fakt AK merr vendimin për refuzim të kërkesës, pa pritur afatin ligjor, duke mos e respektuar nenin 5 të LPP mbi kalkulimin e afateve ligjore. Është indikativ arsyetimi i AK në vendimin për refuzim se kërkesa është dërguar më 15:50, derisa prova e ofruar nga pala në ankesë dëshmon se e-maili është dërguar një orë më vonë më 16:50.

Prandaj, vlerësojmë se refuzimi i Kërkesës për Rishqyrtim si të paplotë nga ana e AK-s, për arsyet që u shpjeguan më lartë, është i pa qëndrueshëm, përkatësisht pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë është i drejtë dhe i bazuar.

<u>Konstatimi 2</u> Gjetjet tona tregojnë se pretendimet kryesore të palës në ankesë kanë të bëjnë me mos respektimin e **kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional** me rastin e vlerësimit të ofertës fituese, të publikuara me Dosje të Tenderit.

Poashtu, gjetjet tona tregojnë se kërkesat mbi aftësitë teknike dhe profesionale të AK në Dosje të Tenderit kanë qenë të qarta.

Në FDT, Pjesa III.2.4 - **Kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe profesional** në pikën 1 precizohet se:- Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi <u>se ka përfunduar me sukses minimum 3 kontrata</u> për shërbime të ngjashme gjatë 3 viteve të fundit (2014,2015, 2016). AK ka kërkuar që të sillet lista e projekteve të realizuara brenda periudhës së kaluar 2014-2016, minimum 3 projekte të përfunduara, por pa e përcaktuar ndonjë vlerë. Poashtu, në Dosje të Tenderit, specifikohet qartë se lista e kontratave duhet të tregojë: *shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe*

pranuesin, duke ia bashkangjitur dëshmi kopjen ereferencës, ose raportin e pranimit të shërbimeve me sukses të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat e cekura në listë.

Pas shqyrtimit detal të dokumentacionit tenderik të ofruar për përmbushjen e këtij kriteri kualifikues, vërejmë se ka pas lëshime në dëshmitë e ofruara dokumentare.

Dilemat që pala në ankesë i ngrit lidhur me interpretimin e kohëzgjatjes në performim që mbulojnë këto kontrata si dhe dëshmive që ka ofruar lidhur me shërbimet e realizuara (pranuara), vlerësojmë se janë të argumentuara. Është e qartë se kontratat e nënshkruara, nuk nënkuptojnë automatikisht zbatimin dhe se artikulimi i kërkesave konkrete që tregojnë aftësinë e pjesëmarrësve për t'i përmbush kontratat në kohëzgjatjen e parashikuar është një kërkesë e mbështetur në ligj.

Në kërkesë saktësohet periudha e shkuar trevjecare, poashtu edhe pranimi i shërbimeve me të gjitha detajet e pranimit. Nëse i referohemi listës së prezentuar të kontratave shohim se vetëm njëra nga këto kontrata është e përfunduar dhe ka një referencë (Kontrata me kompaninë "Modus" shpk, Prishtinë), e cila i plotëson kushtet minimale për t'ju përgjegj kriterit të publikuar, kurse të tjerat vazhdojnë të jenë në zbatim, sepse kanë filluar gjatë vitit 2016, madje njëra në vitin 2017 (jashtë kriterit të kërkuar kohor).Pra, asnjë nga këto kontrata nuk kanë përfunduar brenda periudhës së kërkuar kohore, përkatësisht vazhdojnë të jenë në implementim.

Pa u lëshuar në detaje tjera, duket qartë se kërkesat në formën që janë artikuluar në FDT nuk janë përmbush në tërësinë e vet. Me këtë rast janë anashkaluar dispozitat e nenit 59.4 të LPP, ku ndër të tjera precizohet:
" *Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*"

Prandaj, në përputhje me analizën e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i palës në ankesë edhe në këtë pikë është i bazuar.

Përfundimisht, rekomandimi yne për AK-n, është që me konsekuencë t'i rishikojë dhe rivlerësojë të gjitha ofertat e pranuara dhe të veprojë konform kërkesave, kritereve e nënkritereve të publikuara, me qëllim të vlerësimit objektiv meritor pa paragjykuar rezultatin përfundimtar.

Shkeljet e konstatuara të LPP-s

Gjatë analizimit dhe shqyrtimit të procesit të prokurimit ekspertët shqyrtues konstatojnë se ka pas shkelje të nenit 5 e lidhur me këtë edhe nenit 108/ A lidhur me rishqyrtimin, si dhe të nenit 59 e 60 të LPP 04/L-042 të amandamentuar, dispozita që kanë të bëjnë me ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderit.

Mendimi i ekspertëve shqyrtues - teknik

Ekspertët shqyrtues, duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezentuara me raport, si dhe rrjedhën e vlerësimit nga ana e AK-s, rekomandojnë që ankesa e operatorit" Rosa Security "shpk, Prizren, për tenderin e AK- KK Mamushë, me Nr. të prokurimit 626-17-001-236 të miratohet si e bazuar, dhe i njëjti aktivitet i prokurimit të kthehet në R I V L E R Ë S I M.